

VENDIM
Nr.811, datë 4.6.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA POSHNJË, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendor, komuna Poshnjë, të qarkut të Beratit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 14 (katërmëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Poshnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU

Komuna: **Poshnjë**

Nr	Numri i pasurisë sipas inventarit	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja sipas emertesës popullore	Numri ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha.	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësitë administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	102	Bregu Poshnjes - M kozares	Zalli Larushit	56.a	P Mbrojtes	8.8	Mbrojtes	MMPAU	Komuna	
2	103		Zalli Larushit	56.b	P.Prodhues	2.67	Mbrojtes	"	"	
3	104	"	Rrapi Çiflik	57.a	P. Mbrojtes	4.03	Mbrojtes	"	"	
4	105	"	Rrapi Çiflik	57.b	P. Mbrojtes	15.13	Mbrojtes	"	"	
5	106	"	Rrapi Çiflik	57.c	Sip boshe	3.72		"	"	
6	107	"	Rrapi Çiflik	58.a	P. Mbrojtes	10	Mbrojtes	"	"	
7	108	"	Rrapi Çiflik	58.b	P. Mbrojtes	3.1	Mbrojtes	"	"	
8	109	"	Plepi Arzes stalla	59.a	P. Mbrojtes	24.9	Mbrojtes	"	"	
9	110	"	Plepi Arzes stalla	59.c	P Prodhues	3.43	dru zjari	"	"	
10	111	"	Plepi Arzes st.pompave	60.a	P Prodhues	23.9	L.punimi e d.z	"	"	
11	112	"	Plepi Arzes st.pompave	60.b	P Prodhues	7.1	d.zjari	"	"	
12	114	"	Plepi Hinge	63.a	P Mbrojtes	5.4	Mbrojtes	"	"	
13	115	"	Plepi Hinge	63.b	P Prodhues	2.3	Prodhim thupre	"	"	
14	116	"	Plepi Hinge	63.d	Sip boshe	4.96		"	"	

Numrat e pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
102 - 112	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
114 - 116	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi